



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:171959

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05922288

C.nr.824/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, gjyqtari Selajdin Gallapeni, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike të paditësve A.P, R.C, H.H dhe A.K, të cilët i përfaqëson i autorizuari Z. H, avokat nga P, ndaj të paditurës K e S,D. K e A, të cilën e përfaqëson i autorizuari A. B, përfaqësues ligjor i K së S, për shkak të kompensimit të diferencës së papaguar në emër të licencimit / gradimit, gjykata me qëllim të ekonomizimit të procedurës, jashtë shqyrtimit, më 09.07.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M
- Pa shqyrtim kryesor -

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve A.P, R.C, H.H dhe A.K, ashtu që DETYROHET e paditura K e S, D e A në S, që paditësve në emër të kompensimit të diferencës së papaguar për licencim – gradim, t’ua paguaj shumat si në vijim:

- Paditësit A. P, për periudhën 03.08.2018 e deri më datë 31.12.2022, gjegjësisht për (53 muaj), t’ia paguaj shumën prej 2,193.14 euro;
- Paditësit R. C, për periudhën 03.08.2018 e deri më datë 31.12.2022, gjegjësisht për (53 muaj), t’ia paguaj shumën prej 4,139.30 euro;
- Paditësit H. H, për periudhën 03.08.2018 e deri më datë 31.12.2022, gjegjësisht për (53 muaj), t’ia paguaj shumën prej 4,139.30 euro;
- Paditësit A. K, për periudhën 03.08.2018 e deri më datë 31.12.2022, gjegjësisht për (53 muaj), t’ia paguaj shumën prej 4,139.30 euro.

Të gjitha këto shuma si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, ku kamata fillon të rrjedh prej ditës së parashtrimit të padisë (03.08.2021), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

- II.** REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë për periudhën nga data 01.01.2017 e deri me datë 02.08.2018, për shkak të parashkrimit të kërkesave, ndërsa pjesa tjetër, përtej shumës së aprovuar si në pikën e parë, REFUZHET si e pa bazuar.
- III.** DETYROHET e paditura K e S – D e A, që paditësve t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në vlerë prej 1061.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve përtej shumës së aprovuar si në këtë pikë të dispozitivit, REFUZHET.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarës të tyre, kanë parashtruar padi më datë 03.08.2021, pranë kësaj gjykatë kundër të paditurës K e S – D e A, me të cilën kanë kërkuar kompensimin nga marrëdhënia e punës në emër të gradimit – licencimit, për faktin se kjo e drejtë u buron nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017, tutje i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës, në vendin e punës SH.M.T “Skënder Luarasi” në Suharekë.

E paditura K e S – DKA, përmes të autorizuarit të saj ka theksuar se sa i përket kërkesës për kompensim e kualifikimit arsimor – avancimit në karrierë, e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar për shkak se në rastin konkret paditësit kanë nënshkruar një kontratë të punës ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e në mesin e tyre edhe paga, duke llogaritur edhe gradimin në shumën e caktuar si në kontratën bazë. Po ashtu ka theksuar se paditësit nuk kanë licencë valide dhe gjithashtu është thirrur në institutin e parashkrimit, përkatësisht në nenin 87 të

Ligjit të punës, prandaj në fund ka theksuar se i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e gjykatës të e refuzoj si të pabazuar

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 ndërlidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është **pjesërisht e themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjygjëse nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie punë tek e paditura.

Ky fakt vërtetohet nga kontrata e punës për paditësit.

Kontestues ishte fakti nëse paditësit janë të pajisur me licencë karriere valide dhe nëse të njëjtit janë kompensuar në lidhje me kualifikimin shkollor.

Faktin nëse paditësit janë të pajisur me licencë karriere, gjykata e ka vërtetuar nga licenca me nr.100011989, për paditësin H. H, nga e cila gjykata konstaton se paditësi është i pajisur me licencë të rregullt karriere, që nga data e lëshimit 01.03.2023. Nga licenca me nr.100012000, për paditësin A. P, gjykata konstaton se paditësi është i pajisur me licencë të rregullt karriere, që nga data e lëshimit 01.03.2013. Nga licenca me nr.100011990, për paditësin A. K, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi është i pajisur me licencë të rregullt karriere, që nga data e lëshimit 01.03.2013. Nga licenca me nr.10001206, e lëshuar për paditësin R. C, gjykata konstaton se paditësi është i pajisur me licencë të rregullt karriere, që nga data e lëshimit 01.03.2013.

Ndërsa sa i përket faktit kontestues se paditësit a janë paguar në emër të gradimit, gjykata konstaton se bazuar në listën e pagave, lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për secilin paditës evidentohet se janë paguar në emër të gradimit, mirëpo jo në shumën që ju takon, për çka gjykata vendosi që t'ua njeh diferencën e papaguar si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Deri te shumat aprovuese, gjykata ka ardhur sipas kësaj formule (paga baze e paditësit x niveli i shkollimit, me baçellor 27%, ndërsa me master 35%, minus të ardhurat që i kanë siguruar në emër të gradimit, ku nga kjo shumë e mbetur i është shumëzuar me muajt që i takon të i njihet diferenca e papaguar, duke arritur kështu

në shumën përfundimtare, për të cilat ka vendosur gjykata për secilin paditës veç e veç, si në pikën një të dispozitivit të aktgjykimit).

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese përtej shumës së aprovuar si në pikën dy të dispozitivit, nga përlogaritja e gjykatës, rezulton se shuma që u takon t’i njihet secilit paditës, është shuma si në pikën e parë tek periudha aprovuese, ndërsa pjesa tjetër e kërkuar nga paditësit përtej kësaj shume, gjykata i ka refuzuar për faktin se janë të pabazuara.

Në bazë të Vendimit Nr.01/33, datë 29.08.2008, gjykata gjeti së Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2008, ka marrë vendim, ku sipas pikës 3 të këtij vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”.

Ndërsa në pikën 4 theksohet se, citojmë: *Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët), dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur:*

- 1) *Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10 %;*
- 2) *Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19 %;*
- 3) *Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %;*
- 4) *Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë), përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.*

Në bazë të provave të administruara, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Sipas nenit 7 par. 1, pika 1.1, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 01B-Nr.prot.2056, e cila ka hyrë në fuqi nga data 18.04.2017, është paraparë së “*Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit.*

Lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë si në pikën dy të dispozitivit, gjykata konstaton se paditësve nuk u takon t'u njihet diferenca e papaguar në emër të gradimit, për shkak se pala e paditur në përgjigje në padi ka deklaruar se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, i cili thotë se, citojmë “ *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Gjkata pas vlerësimit të pretendimeve të palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesave, thekson se i njëjti pretendim qëndron, për faktin se padia është paraqitur me datë 03.08.2021, ndërsa nëse kthehemi tre vite mbrapa, atëherë i bie që kërkesëpadia duhet të aprovohet nga data 03.08.2018, gjegjësisht për periudhën tre vjeçare nga data e paraqitjes së kërkesës – padisë, ndërsa pjesa tjetër prej datës 01.01.2017 e deri me datë 02.08.2018, duhet të refuzohet për faktin se është parashkruar.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë, në shumë prej 520.00 euro, për kontestet deri në katër paditës, me vlerë të objektit të kontestit mbi 10.000.00 euro, për precizim shumen prej 520.00 euro, për taksë gjyqësore për padi, shumën prej 21.00 euro, që të gjitha këto në shumën të përgjithshme prej 1061.00 euro sipas TOAK-së.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat e në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:171959, 10.07.2024**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.